



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:130148

Datë: 05.10.2023

Numri i dokumentit: 04758705

Pml.nr.508/2023

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Mejreme Memaj dhe Rasim Rasimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale të të pandehurit H. J., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par. 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurit av. Florim H. Shefqeti dhe av. Shemsedin Pira, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PPRKR.nr.143/2023 të datës 7.9.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.975/2023 të datës 15.9.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 5.10.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me pranimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurit H. J., ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PPRKR.nr.143/2023 të datës 7.9.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.975/2023 të datës 15.9.2023, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lirohet menjëherë për t'u mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.143/2023 të datës 7.9.2023, të pandehurin H. J., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj e cila masë sipas këtij aktvendimi do t'i zgjasë nga data 8.9.2023 deri më datën 8.11.2023, konform nenit 184 par.1 dhe 2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.975/2023 e datës 215.9.2023, i ka refuzuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurit si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit H. J. av. Florim H. Shefqeti, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit ose ndaj tij të caktohet ndonjëra nga masat alternative, dhe
- mbrojtësi i të pandehurit H. J. av. Shemsedin Pira, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par. 1 nën par. 1.1 të KPP dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor nga neni 432 par. 1 nën par. 1.3 të KPP, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit ose çështja të anulohet dhe të kthehet në rivendosje.

Prokurori i Shtetit Kosovës, me parashtrësën KMLP.III.nr.213/2023 e datës 4.10.2023 dhe 8.10.2023, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara, ngase pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesave të mbrojtësve të të pandehurit, kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe e pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se këto aktvendime janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheqin vërejtjen mbrojtësit në kërkesat e tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë dhënë arsyetim bindës dhe të qëndrueshëm përkitazi me bazat e paraburgimit. Përkatësisht nuk kanë analizuar në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete të pranimit të kërkesës për vazhdimin e paraburgimit, por më tepër kanë bërë përshkrim formal dhe abstrakt të shkaqeve

dhe kriterëve të parashikuara me ligj, duke mos precizuar mundësinë e asgjësimit, fshehjes, ndryshimit ose falsifikimit të provave të veprës penale si dhe mënyrën e ndikimit në dëshmitarë pa cekur asnjë emër, rrethanat e cekura janë të karakterit abstrakt dhe pa mbështetje. Vazhdimi i paraburgimit me arsyetimin se i pandehuri po refuzon të jap kodin e telefonit për ekzaminimin e provave, kur telefoni është sekuestruar, dhe se nga data 8.6.2023 ndodhet në paraburgim e gjithashtu, duke vlerësuar arsyetimin e gjykatave respektive përkitazi me nenin 184, paragrafi 1., nën par. 1.1., pika 1.2.3., të KPP, është evidente se arsyetimet janë të natyrës supozuese dhe pa mbështetje në prova konkrete, meqë rreziku i përsëritjes duhet të jetë i konkretizuar dhe i bazuar në prova konkrete dhe në asnjë rrethanë në supozime të pakonfirmuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes posaçërisht ka pasur parasysh dhe ka aplikuar nenin 184 të KPP se: *“Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se përmbushet njëri nga kushtet e paraparë me ligj (përveç dyshimit të bazuar edhe bazat e artikulueshme nga pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të par.1.2 të nenit të lartcekur) dhe në rast se nuk përmbushen këto kushte (neni 163 paragrafi, 4.i KPP) i pandehuri apo e pandehura lirohet”,* që nga interpretimi logjik i kësaj dispozite mund të konkludohet se paraburgimi paraqet masën e fundit *“ultima ratio”* dhe e cila duhet të aplikohet vetëm përjashtimisht dhe nën kushte të përcaktuara dhe të argumentuara.

Për këtë arsye, kolegji i kësaj gjykate, konform nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPPK, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Pml.nr.508/2023 me datën 5.10.2023.

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka